

SITUATA ME TË DREJTAT E NJERIUT – RAPORT MUJOR

KORRIK

20

25

SITUATA ME TË DREJTAT E NJERIUT – RAPORT MUJOR

Kjo botim u financua nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Shkup dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



Funded by
the European Union



Фундаменталните човекови права
на прво место: Активен придонес
за владеење на правото



Содржината на овој продукт е единствена одговорност на Хелсиншкиот комитет за човекови права и на никаков начин не може да се смета дека ги одразува гледиштата на Европската Унија.

PËRMBAJTJA

01

Hyrje

02

Gjuha e urrejtjes

03

Veprat nga urrejtja

04

**Institucione të
mbyllura**

05

**Ndihmë juridike
falas**

HYRJE

Muaji korrik u shënua nga disa reagime nga organizatat dhe platformat e shoqërisë civile. Në fillim të korrikut, Grupi Blueprint për Reformën Gjyqësore shprehu shqetësime serioze në lidhje me mënyrën se si Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut (KGJRMV) kreu zgjedhjen e ushtruesit të detyrës të kryetarit të Gjykatës Themelore Penale Shkup në seancën publike të mbajtur më 3 korrik 2025.

Konkretisht, në seancë u zgjodhën disa u.d. kryetarë të gjykatave themelore për shkak të skadimit ose ndërprerjes së mandatit të kryetarëve të mëparshëm, por nuk kishte konsistencë në mënyrën dhe procedurën për zgjedhjen e u.d. kryetarëve të rinj. Grupi Blueprint theksoi se respektimi i ligjeve dhe procedurave të parashikuara në përputhje me rregulloret ligjore duhet të jetë i vetmi imperativ dhe standard përmes të cilit garantohet pavarësia dhe autonomia e gjyqtarëve.

Grupi Blueprint për Reformën Gjyqësore reagoi gjithashtu ndaj emërimit të këshilltarit special të Ministrit të Drejtësisë, *Andreja Vesov*, si anëtar i Këshillit Programor të Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë.

HYRJE

Sipas nenit 19 të Ligjit për *Akademine* e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, një "nëpunës i lartë civil nga Ministria e Drejtësisë me të paktën tetë vjet përvojë pune në fushën e drejtësisë, pas kalimit të provimit të jurisprudencës, mund të zgjidhet si anëtar i Këshillit Programor". Prandaj, sipas informacionit të disponueshëm publikisht, anëtari i Këshillit Programor që është emëruar është i punësuar si këshilltar special i Ministrit të Drejtësisë, një pozicion që nuk kualifikohet si nëpunës i lartë civil sipas Ligjit për Nëpunësit Administrativë, por si një angazhim me afat të caktuar sipas Ligjit për Punonjësit e Sektorit Publik. Përveç kësaj, lidhja e tij me një parti të caktuar politike dhe kandidimi për deputet në zgjedhjet e fundit parlamentare dëmton seriozisht perceptimin e pavarësisë dhe paanshmërisë së Akademisë.

Rrjeti për Mbrojtjen nga Diskriminimi reagoi ndaj Projektligjit për Shkollat Fetare duke thënë se është jokushtetues, në mospajtim me ligjet dhe një përpjekje e rrezikshme për të minuar karakterin laik të shtetit. Rrjeti kërkoi tërheqjen e menjëhershme të Projektligjit dhe i bëri thirrje Qeverisë t'i përmbahet parimit kushtetues të sekularizmit, pasi miratimi i një ligji të tillë përfaqëson një largim serioz nga vlerat demokratike dhe qytetare dhe një kërcënim të drejtpërdrejtë për të drejtat e nxënësve dhe integritetin e sistemit arsimor.

HYRJE

Menjëherë më pas, Rrjeti për Mbrojtje nga Diskriminimi shprehu një reagim të ashpër ndaj deklaratave të Kryeministrit, Hristijan Mickovski, se po shqyrtohet mundësia e vendosjes së taksave shtesë për personat e pamartuar. Rrjeti paralajmëroi se taksa të tilla do të përbënin kërcënim për të drejtat themelore të njeriut dhe parimet e barazisë dhe lirisë. Një masë e tillë në të ardhmen jo vetëm që do të ishte retrograde, por edhe diskriminuese, sepse shkel të drejtat e njeriut, pra të drejtën për të zgjedhur, të drejtën për jetë private dhe familjare dhe të drejtën për të planifikuar një familje, stil jetese, status familjar dhe të ardhme..

Më 7 korrik, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i bëri thirrje Ministrisë së Shëndetësisë që të përmbahet nga vendosja e kufizimeve joformale në punën e mediave dhe i inkurajoi gazetarët të vazhdojnë të raportojnë profesionalisht, me etikë dhe me ndjeshmëri ndaj viktimave të tragjedisë në Koçani, por me një ndjenjë të qartë përgjegjësie ndaj interesit publik, pasi çdo përpjekje për të kufizuar këto parime përbën një kërcënim për të drejtat dhe liritë e të gjithë qytetarëve.

HYRJE

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dënoi ashpër sulmin fizik dhe verbal ndaj Kryetares së Qytetit të Shkupit, Danela Arsovska, i cili ndodhi më 11 korrik, gjatë një inspektimi zyrtar të një kantieri ndërtimi të paligjshëm. Në këtë rast, Komiteti i Helsinkit kërkoi një hetim të menjëhershëm dhe të pavarur të rastit, përgjegjësi për nëpunësit e policisë që nuk vepruan siç duhet në vendngjarje, padi penale kundër autorëve dhe procedim përkatës kundër tyre, sigurimin e mbrojtjes efektive dhe të menjëhershme për Kryetaren e Qytetit dhe zyrtarët e tjerë që u sulmuan, si dhe dënimin e sulmit nga të gjithë aktorët politikë dhe shoqërorë. Komiteti i Helsinkit vlerësoi se dështimi i institucioneve për të vepruar në rastet e dhunës së dukshme jo vetëm që inkurajon një kulturë të pandëshkueshmërisë, por kërcënon drejtpërdrejt sundimin e ligjit dhe demokracinë.

Platforma për Barazi Gjinore reagoi ashpër ndaj projekt-amendamenteve në Ligjin e Policisë, të cilat propozojnë fshirjen e nenit 96 nga ligji aktual, një nen që përcakton qartë detyrimin për të respektuar parimin e barazisë gjatë punësimit në polici.

HYRJE

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi (KPMD) kanë ngritur një padi me interes publik në gjykatën kompetente kundër Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ministrisë së Shëndetësisë për shkak të diskriminimit sistematik dhe të vazhdueshëm ndaj grave fermere individuale, të siguruara në sistemin e detyrueshëm të sigurimit shëndetësor. Rasti ka të bëjë me boshllëkun ligjor që përjashton fermeret individuale nga e drejta për pushim të paguar për lindje dhe pushim mjekësor, pavarësisht faktit se ato paguajnë rregullisht sigurim shëndetësor dhe social. Kjo i vendos fermeret femra në një pozicion të pabarabartë krahasuar me personat e tjerë të siguruar, gjë që përbën diskriminim ndërsektorial në bazë të seksit, gjinisë, statusit personal dhe përkatësisë në një grup të marginalizuar.

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut ka dënuar publikisht vendimin e Kuvendit për të mos votuar Rezolutën që kërkon që Izraeli të lejojë hyrjen e ushqimit dhe furnizimeve mjekësore për civilët në Gaza. Ky vendim e pozicionon Republikën e Maqedonisë së Veriut në anën e atyre që shkelin të drejtat e njeriut në mënyrën më brutale.

HYRJE

Në vend që të veprojnë dhe të vendosin për të zvogëluar vuajtjet e personave të mbijetuar në Gaza, deputetët tanë, me këtë vendim, kontribuan në vazhdimin e asaj vuajtjeje, pra shfarosjen sistematike aktualisht duke i lënë të vdesin urie një popullsi prej dy milionë civilësh, përfshirë të porsalindur dhe fëmijë.


Grupi Blueprint për Reformën Gjyqësore reagoi ndaj propozimit për ndryshimin e Ligjit për Policinë, i cili heq kriteret që kërkojnë që drejtori i Byrosë së Sigurisë Publike të ketë një arsim në fushën e sigurisë, drejtësisë, mbrojtjes ose ekonomisë. Në vend të kriterit të mëparshëm, ndryshimet e propozuara lejojnë që personi të ketë përfunduar çdo arsim të lartë në fushën e shkencave shoqërore. Kjo qasje dhe heqja e kriterëve për arsim dhe ekspertizë hap hapësirë për emërime politike pa kualifikime të përshtatshme, zhvlerëson njohuritë si parakusht për udhëheqjen e institucioneve dhe minon besimin e qytetarëve në institucione dhe legjitimitetin e tyre.

SITUATA ME GJUHËN E URREJTJES NË REPUNLIKËN E MQEDONISË SË VERIUT, RAPORT MUJOR - KORRIK 2025

Gjatë muajit korrik 2025, në platformën ueb www.govornaomraza.mk u regjistruan gjithsej 26 raste, nga të cilat 14 (44%) ishin të bazuara në përkatësi etnike, 5 raste (16%) në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor dhe 5 raste (16%) në bazë të përkatësisë politike, të cilat përmbajnë elemente të gjuhës së urrejtjes, nxitjes dhe thirrjes për diskriminim dhe ngacmim.

Këtë muaj, ndihej atmosfera parazgjedhore, në të cilën tensioni ndëretnik ishte në rritje, madje u vu re gjuhë fyese dhe nënçmuese midis dy komuniteteve më të mëdha në vend. Megjithatë, si rezultat i disa politikave që mohojnë të drejtat e komunitetit LGBTI, ishte i dukshëm edhe përçmimi ndaj këtij komuniteti të marginalizuar.

PARAQITJE GRAFIKE E SITUATËS ME GJUHËN E URREJTJES NË MUAJIN KORRIK 2025



- Gjuhë e urrejtjes për shkak të përkatësisë etnike
- Gjuhë e urrejtjes për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor
- Gjuhë e urrejtjes për shkak të përkatësisë politike
- Gjuhë e urrejtjes bazuar në përkatësinë kombëtare
- Gjuhë e urrejtjes për shkak të gjinisë dhe llojit (seksit)
- Gjuhë e urrejtjes për shkak të fesë dhe bindjeve fetare

***Në platformë janë regjistruar 26 raste origjinale të gjuhës së urrejtjes - në disa raste, është regjistruar më shumë se një karakteristikë mbrojtëse.**

SITUATA ME GJUHËN E URREJTJES NË REPUNLIKËN E MQEDONISË SË VERIUT, RAPORT MUJOR - KORRIK 2025

PËRFUNDIM DHE REKOMANDIM

Përfundim

Të dhënat për muajin korrik 2025 tregojnë një rritje të numrit të rasteve të gjuhës së urrejtjes që lidhen me përkatësinë etnike, si dhe presion të vazhdueshëm mbi komunitetin LGBTI. Fenomene të tilla pasqyrojnë klimën shoqërore të polarizuar dhe ndërgjegjësimin e pamjaftueshëm publik për pasojat e gjuhës së urrejtjes.

Rekomandim

Rekomandohet të forcohet reagimi institucional përmes trajtimit më efikas të raporteve dhe llogaridhënies së autoriteteve kompetente. Është e nevojshme të iniciohen fushata publike për të promovuar tolerancën dhe respektin për diversitetin, veçanërisht tek të rinjtë.

SITUATA ME VEPRAT NGA GJUHA E URREJTJES NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, RAPORT MUJOR - KORRIK 2025

Gjatë muajit korrik 2025, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut regjistroi 3 incidente të mundshme me motiv të njëanshëm, për pjesën më të madhe të të cilave, në përputhje me tregues të tjerë (vendndodhja, metoda e kryerjes, përfshirja e të miturve dhe nxënësve të shkollave të mesme, etj.), ekziston një bindje e arsyeshme se ato janë kryer për shkak të përkatësisë etnike të viktimës, pra autorit të veprës. Konkretisht, ekzistojnë 2 incidente të mundshme bazuar në përkatësi etnike dhe një incident bazuar në përkatësi politike. Sipas llojit të dhunës, një incident përmban dhunë, në një rast ka të bëjë me rrezikimin e sigurisë dhe në të tretin - përdhosjen e simboleve. Në një rast, si viktimat ashtu edhe autorët ishin të mitur. Një kallëzim penal është ngritur për shkak të ekzistencës së bazave të dyshimit për veprën penale "përhapja e materialit racist dhe ksenofobik përmes një sistemi kompjuterik", sepse, përmes rrjetit social, personi i raportuar ka ndarë një video që nxit urrejtje dhe intolerancë.

Incidentet e mundshme përfshihen në raport sepse ato lidhen me situata ku, sipas treguesve të tjerë, ka arsye për të besuar se këto incidente janë të motivuara nga njëanshmëria/paragjykime. Këta tregues të njëanshmërisë përfshijnë: perceptimin e viktimës/dëshmitarit; komentet në vendngjarje; dallimin etnik midis viktimës dhe autorit të veprës; modelin/frekuencën e incidenteve të mëparshme; natyrën e dhunës; mungesën e motiveve të tjera; dhe vendndodhjen dhe kohën.

SITUATA ME VEPRAT NGA GJUHA E URREJTJES NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, RAPORT MUJOR - KORRIK 2025

Në mënyrë specifike, incidentet e mundshme përfshihen në këtë raport për shkak të informacionit të marrë në lidhje me vendndodhjen (p.sh., lagje ose shkollë etnikisht e përzier, linjat e autobusëve të përdorura nga anëtarë të komuniteteve të ndryshme etnike, vendet ku kanë ndodhur vepra urrejtjeje në të kaluarën), llojin (p.sh., një grup i madh të miturish që sulmojnë një ose më shumë viktima pa asnjë provokim, përleshje bandash, sulme ndaj autobusëve ose në stacionet e autobusëve), kohën (p.sh., pas përleshjeve të mëparshme si një formë hakmarrjeje, pas shkollës, gjatë ose pas një ndeshjeje sportive) dhe pronën e dëmtuar gjatë incidentit (p.sh., vendet e adhurimit fetar).

SITUATA ME VEPRAT NGA GJUHA E URREJTJES NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, RAPORT MUJOR - KORRIK 2025

PËRFUNDIM DHE REKOMANDIM

Përfundime:

1. Skema e ngjarjeve tregon se motivet paragjyquese/njëanshmërisë janë kryesisht etnike, me forma të ndryshme (dhunë fizike, rrezikim i sigurisë, përdhosje e simboleve), kurse të miturit shfaqen si viktimashtu dhe autorë.
2. Incidentet janë të grupuara rreth "konteksteve të rrezikut" (shkolla, lagje të përziera, linja/stacione autobusësh, periudha pas ndeshjeve sportive), dhe ekziston edhe një dimension online që përshkallëzohet në gjuhë urrejtjeje dhe nxitje për intolerancë.

Rekomandime:

- Krijimi i partneriteteve me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, shkollat dhe NPT (JSP), mësuesit në detyrë/shërbimin e sigurisë pas mbarimit të mësimeve, edukimi mbi parandalimin e urrejtjes, protokollet e qarta të raportimit dhe reagimi i shpejtë, me theks të veçantë në punën me të miturit.
- Monitorim sistematik, udhëzime për platformat dhe publikun për të raportuar, mbështetje ligjore për viktimat, koordinim me Ministrinë e Punëve të Brendshme/Prokurorinë Publike për zbatimin konsistent të veprës penale të "përhapjes së materialit racist dhe ksenofobik".

SITUATA ME INSTITUCIONET E MBYLLURA NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, RAPORT MUJOR - KORRIK 2025

1. Pasqyrë e përgjithshme e aktiviteteve

Gjatë muajit korrik 2025, Komiteti i Helsinkit ofroi ndihmë juridike falas për personat e dënuar në tre raste, përkatësisht:

- **Një rast: Lirim me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse;**
- **Një rast: Rast paraburgimi;**
- **Një rast: Angazhimi në punë i një personi të dënuar në institucion.**

2. Pasqyrë e shkurtër e shërbimeve juridike të ofruara

- **Rishikimi i legjislacionit dhe këshillave ligjore të ofruara personave të dënuar/të paraburgosur dhe familjeve të tyre.**
- **Kërkesa për qasje të lirë në informacion të parashtruara institucioneve kompetente.**
- **Ofrimi i informacionit ligjor, këshillave dhe referimeve për klientët.**

3. Përfundime dhe rekomandime

- **Të inkurajohet dhe zgjerohet zbatimi i masave alternative, veçanërisht lirimi me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse, me qëllim uljen e mbipopullimit, përmirësimin e risocializimit dhe përdorimin racional të burimeve..**
- **Të përmirësohet dhe rritet diversiteti i aktiviteteve të punës për fitimin e aftësive praktike që do të ndihmojnë në risocializimin e personave të dënuar dhe integrimin më të lehtë pas daljes nga institucioni.**

TË DHËNA STATISTIKORE PËR NJF PËR MUAJIN KORRIK 2025

NJF	29	
NJD	/	
Gjithsej	29	
	Numri	Përqindja
Gjinia		
Meshkuj	16	42
Femra	13	58
Përkatësia etnike		
Maqedonë	26	835
Shqiptarë	3	65
Romë	1	10
Të huaj	1	0
Rajonet gjeografike		
Shkup	19	745
Vardar	1	3
Pollog	0	0
Pellagoni	3	65
Jugperndim	1	0
Verilindje	0	65
Lindje	3	3
Juglindje	2	65

TË DHËNA STATISTIKORE PËR NJF PËR MUAJIN KORRIK 2025

Fusha juridike	Numri	Përqindja
E drejta pronësore	9	13
Mbrojtja dhe sigurimi social	2	65
Mbrojtja e fëmijëve	2	65
Sigurimi pensional dhe invalidor	1	3
Sigurimi shëndetësor dhe	1	0
Marrëdhëniet e punës	6	33
Dhuna me bazë gjinore dhe dhuna	1	3
Çështje statusore	3	3
Mbrojtja e të drejtave të njeriut	2	19
Të tjera	2	13

RAST STUDIMI PËR NDIHMË JURIDIKE DYTËSORE - PENGESA LIGJORE PËR PËRFAQËSIM NË PROCEDURË ADMINISTRATIVE (ÇËSHTJE PRONËSORE- JURIDIKE)

Një grua e moshuar nga Shtipi, shfrytëzuese e një strehimoreje humanitare që i ishte ndarë nga Komuna 20 vjet më parë, iu drejtua Komitetit të Helsinkit për ndihmë juridike falas. Të drejtat dhe detyrimet e saj, përkatësisht mënyra e përdorimit të strehimores, nuk ishin të rregulluara me asnjë akt ligjor (kontratë, rregullore etj.), por ajo u dëbua nga ana e shërbimeve të Komunës sepse strehimorja ishte e lënë pas dore, nuk mirëmbahej rregullisht dhe askush nuk kishte jetuar në të për një kohë të gjatë. Bazuar në këtë situatë faktike të vërtetuar gabimisht, ndërsa paditësja qëndronte me vajzën e saj në Shkup për disa muaj dhe punonte sezonalisht jashtë vendit, Komuna kreu një procedurë për të dëbuar paditësen, për të zbrazur strehimoren humanitare dhe për të vendosur një person tjetër aty. Me fjalë të tjera, paditësja mbeti e pastrehë brenda natës, pa marrë asnjë njoftim për këto veprime nga Komuna. Kur shkoi të pyeste se çfarë po ndodhte, asaj iu tha se procedura kishte përfunduar ligjërisht me një njoftim në tabelën e njoftimeve të Komunës. Kur kërkoi qasje në dokumentacionin e Komunës, ajo vuri re se njoftimet drejtuar saj në lidhje me procedurën për konfiskimin e strehimores ishin dërguar në adresën e gabuar (të mëparshme) të paditëses, pra në adresën ku ajo jetonte 20 vjet më parë

RAST STUDIMI PËR NDIHMË JURIDIKE DYTËSORE - PENGESA LIGJORE PËR PËRFAQËSIM NË PROCEDURË ADMINISTRATIVE (ÇËSHTJE PRONËSORE- JURIDIKE)

Gjatë gjithë vitit 2025, Komiteti i Helsinkit i ofroi vazhdimisht ndihmë juridike aplikueses, nga Kërkesat për inspektim dhe transkriptim të dokumenteve, përmes Kërkesave për rivendosje në gjendjen e mëparshme, deri te Kërkesat për mbikëqyrje inspektuese, duke marrë parasysh se Komuna i kishte tejkaluar afatet për vendimmarrje, si në lidhje me Kërkesën për rivendosje në gjendjen e mëparshme, ashtu edhe për ankesën pas refuzimit të kësaj Kërkese.

RAST STUDI MI PËR NDIHMË JURIDIKE DYTËSORE - PENGESA LIGJORE PËR PËRFAQËSIM NË PROCEDURË ADMINISTRATIVE (ÇËSHTJE PRONËSORE- JURIDIKE) PERFUNDIME DHE REKOMANDIME

Ligji për Ndhimën Juridike Falas përmban një lëshim serioz në pjesën e kushteve për miratimin e ndihmës juridike dytësore për qytetarët në rrezik social (madje edhe pa strehë, si në këtë rast të veçantë). Kështu, sipas Nenit 22 (me nëntitull: arsytet për refuzimin e ndihmës juridike dytësore), kërkesa për ndihmë juridike dytësore do të refuzohet nëse ka të bëjë me çështje pronësore në një procedurë administrative.

Konkretisht, ligjvënësi vendosi për këtë dispozitë, ndoshta duke marrë parasysh mijëra procedura administrative para komunave dhe Agjencisë së Kadastrës së Patundshmërive, të cilat kanë të bëjnë me çështje pronësore (siç janë, për shembull: regjistrimi i ndryshimeve në të dhënat kadastrale, privatizimi, legalizimi, denacionalizimi, shpronësimi etj.). Megjithatë, në këtë rast, kur bëhet fjalë për një procedurë administrative për dëbimin e një personi në rrezik social nga një strehim humanitar, situata faktike dhe ligjore është krejtësisht e ndryshme, përkatësisht hyn në fushën e mbrojtjes sociale për të cilën nuk zbatohen dispozitat kufizuese të nenit 22 të Ligjit për Ndhimën Juridike Falas.

Për shkak të gjithë asaj që u tha më sipër, ne rekomandojmë përsëri ndryshime ligjore që synojnë lehtësimin e kushteve për miratimin e NJD-së në një procedurë administrative, veçanërisht për personat në rrezik social, çështja e pronësisë së të cilëve lidhet ekskluzivisht me të vetmen pronë që kanë - vendbanimin e tyre.